

Emri i Lëndës : Bazat e Semiotikes							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 201	A	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Rahim Ombashi, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		"Bazat e Semiotikës dhe ligjet e saj» paraqet interes në lidhje me atë, që gjithçka që na rrethon janë shenja specifike: dukuritë e natyrës, programet kompjuterke, piktura, muzika dhe, sigurisht, gjuha, si në nivelin artistike, ashtu dhe në gjendjen e saj të natyrshme. Njeriu jeton në botën e shenjave, përdor shenjat dhe në situata të caktuara vetë përfaqëson një shenjë. Të ecurit e njeriut, veçantia e figurës së tij, timbri i zërit, forma e qethjes - ja pra një komplet i plotë shenjash, sipas të cilave ne ia qëllojmë mënjëherë një të njohuri. Shkenca që merret me studimin dhe interpretimin e shenjave dhe sistemeve shenjore, të krijuara me bazën e tyre, quhet Semiotikë. Sistemi shenjoyr - është një sistem, që transmeton një informacion, të ndryshëm nga energjia. Ai ekziston objektivist, pavarësisht nga vëzhguesi. Një prej sistemeve më të rëndësishme të sistemit shenjoyr, të krijuar prej njeriut është gjuha natyrale, ose gjuha e folur. Ndërkaq Semiotika, si shkenca e përgjithshme mbi shenjat, merret me studimin jo vetë të gjuhëve natyrale. Në orbitën e saj përfshihen dukuri të tilla të kulturës, si kinemaja, teatri, piktura dhe arkitektura. Përderisa shenja është bartëse e informacionit, semiotika ka një domethënie të madhe aplikative gjatë studimit dhe projektimit të sistemit shenjoyr, të shfrytëzuar në procesin e transmetimit dhe përpunimit të informacionit. Përpunimet aplikative shkojnë sipas dy drejtimeve themelore. I pari është krijimi i gjuhëve artificiale, që mundësojnë lehtë të algoritmosh proceset e përpunimit të informacionit si për shembull, të gjuhëve të programimit, gjuhëve të indeksimit të dokumentave etj.). Drejtimi i dytë është krijimi i algoritmeve, që lehtësojnë përpunimin e teksteve në gjuhën natyrale (përkthimi kompjuterik, indeksimi dhe referencat automatike, përkthimi nga gjuha natyrale në gjuhën formale etj.). Së këndejmi mund të nxjerrim një konkluzion, që shkenca e Semiotikës është kyçe dhe aktuale në të gjitha proceset e komunikimit. Kursi i leksioneve "Bazat e semiotikës" i kushtohet ligjeve themelore të kësaj shkence relativisht të re mbi gjuhën dhe shenjat në shembullin e sistemeve të ndryshme shenjore, duke sjelle ilustrime të analizave nga rrafshet krahasuese, dhe po ashtu, duke studiuar natyrën e veçantë të shenjave dhe funksionimin e tyre në jetën e njerëzve. Së këndejmi, në cilësinë e objektit të kësaj lënde janë drejtpërdrejt shenjat. Objekt i leksioneve është funksionimi i shenjave dhe sistemeve shenjore në jetën e njerëzve dhe në gjuhë, si mjet bazë për përcjelljen e kuptimit, të cilat ekzistojnë, duke iu bindur ligjëzive të caktuara. Problem i rëndësishëm është kufizimi i saktë i domethënies së shenjës (denotative dhe sinjifikative).					
Objektivat		Qëllimi i këtij kursi leksionesh ka të bëjë me shqyrtimin dhe interpretimin e Semiotikës si shkenca mbi shenjat, funksionimi i isaj si një sistem unik si dhe detyrat që merr përsipër kjo shkencë në etapën bashkëkohore të zhvillimit të saj. Në akord me qëllimin e shtruar studentët do të ushtrohen në detyrat humumtuese si më poshtë: - të mësojnë qartë e vërtetueshëm shkencën e semiotikës dhe ligjësitë e saj; - të përvetësojnë historinë e zhvillimit të semiotikës në etapa të ndryshme historike; -të analizojnë tipologjinë e shenjave; - të përcaktojnë arsyet për krijimin e ligjeve semiotike; - të shqyrtojnë ligjet semiotike (pragmatika, semantika, sintaktika). Në akord me detyrat, struktura e leksioneve përfshin temat qëndrore që do të orientojnë seminarët, punimet dhe shfrytëzimin e literaturës.					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							

Java	Tema
1	Në botën e Semiotikës; - Çfarë është semiotika? - Nocioni mbi semiotiken dhe përbërësit e saj - tekstet, shenjat. - Humbja e Gjuhës: kur gjuha del e tepërt. - Shenja. Njerezit dhe shenjat. Llojet e shenjave
2	- Situatat e komunikimit dhe llojet e tyre; - Sistemet shenjore -Çfare do te thotë sistem? - Si është ndertuar një sistem shenjoy.
3	Rregullat e pwrdorimit të Sistemeve shenjore; - Veprimi i ndësjelltë i sistemeve shenjore - Përkthimi - Përdorimi dytësor i shenjave
4	- Shenjat në kulturë - Numra të mençur - Duart dhe shenjat - Gurët shndërrohen gjithshu në shenja. - Gjuha e vallëzimit -Gjuha si sistem shenjoy
5	- Nivelet e receptimit te tekstit semiotik dhe interpretimi i tij - Shenjat, thelbi dhe cilësitë e saj - Struktura e klasifikimit të shenjave
6	- Tre dimensionet e tekstit semiotik
7	Bazat semiotike të veprimtarisë komunikative - Marrëdhëniet komunikative në sistemin
8	Provim Gjysmëfinal
9	-Analiza semiotike e mesazhit të reklamës - Analiza komplekse e mesazhit të reklamës
10	- Reklama si tekst i kreolizuar - Baza metaforike e tekstit të kreolizuar të reklamës.
11	- Njësitë themelore dhe nocionet e semiotikës së tekstit. - Nocioni i shprehjes - Sintaktika
12	- Mbi atmosferwn e semiotikës - Semantika - Pragmatika
13	Semiosfera - Interteksti dhe Inosfera (sfera e informacionit - informsfera) - Semiotika e gjesteve:
14	- Mbi Gjuhën e shurdhmemecëve - Mbi vëllezerit tanë të vegjël (kafshët) - Mbi paratë - Mbi gradat dhe dekoratat
15	- Mbi gradat dhe dekoratat - Mbi lulet dhe ngjyrat - Mbi bletët - Mbi sistemin e numërimit
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Maria Pia Pozato, Semiotika e Tekstit, SHBLU, Tiranë, 2005. • Vladimir Propp "Morfologjia e përrallës", Pika pa sipërfaqe", Tiranë 2010 (përkthim i A. Tufës). • Juril Lloman: "Kultura dhe Bumi", Pika pa sipërfaqe, Tiranë 2010 (Përkthi i A. Tufës) • Ekko Umberto "Mbi letërsinë", Dituria, 2009. • Italo Calvino: "Leksonte Amerikane", SHLK, Tiranë 2008 • Barthes Rolan "Aventura semiotologjike", Dukagjini, Prishtinë 2007. • Rahim Ombashi, Bazat e semiotikës së tekstit, Dispensë. (Cikël leksionesh hartuar duke u bazuar në literaturën e detyrueshme, por edhe në atë të këshillueshme).
Referenca të tjera	• Sabri Hamiti, Poetika shqipe, Tiranë, 2010. • Terry Eagleton, Literary theory – an introduction, (Anniversary Edition) MINESOTA, Minneapolis, 2008. • Terry Eagleton, Hyrje në teorinë e letërsisë, Shkodër, 2005. • Rexhep Murtez Shala, Komunikimi modern-Theory, Prishtinë, 2001. • Rexhep Murtez Shala, Teoria e metakomunikimit, Prishtinë, 2005. • Rexhep Murtez Shala, Analiza - kognicioni dhe modelimi, Prishtinë, 2010. • Ledio Orozi, Hyrje në teorinë e komunikimit, Tiranë, 2010, • Myzaferre Mustafa, PËRRALLA SHQIPTARE - Poetikja dhe mitikja, Prishtinë, 2003. • Rahim Ombashi, Hyrje në teorinë e letërsisë, Korçë, 2006. • Aurel Plasari, Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve, Tiranë, 1995. • Aurel Plasari, Don Kishoti zbret në Shqipëri, Tiranë, 1990, fq. 25 • Agim Vinca, Kurs i teorive letrare, Prishtinë, 2002. • Rene Wellek and Austin Warren, Theory of Literature, New York, 1956.
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të shkruarit
2	Studenti duhet të kryejë punime me nivel të lartë shkencor (ese, detyra kursi, punim diploma)
3	Të nxitet të menduarit kritik duke u shfaqur në aktin e ndjeshmërisë së veprës si dhe të kuptuarit të saj.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	20	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	1	20	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	1	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			124
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.96
ECTS			5.00